



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 78/2 Prot.,

Tiranë, më 15.01. 2024

**SHPALLJE**  
**TË LISTËS SË KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR**  
**DPAKU**

Në mbështetje të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSIP”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr.297 datë 23.6.2022. të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ligjit nr. Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 708 datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Manuali i Rekrutimit (i ndryshuar),

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**, në përfundim të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të dorëzuara nga kandidatët për 1 (një) pozicion të lirë pune të shpallur në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së,

• 1 (një) pozicion të lirë pune **“Përgjegjës”** në Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Raportimit në Drejtorinë e Vlerësimit të Riskut në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së;

**N J O F T O N:**

1. Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit është si vijon:

- **Z. Edvin Gruçka**
- **Z. Nderim Balliu**

2. Intervista do të zhvillohet më datë **17.1.2024, ora 10:30**, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, adresa Rruga “Bardhyl”, Ndërtesa Nr. 93, Njësia Administrative Nr. 3, Tiranë.

3. Kandidatët do të intervistohet në lidhje me:

- Njohuri të përgjithshme për Kodin e Punës për të drejtat e detyrimet e punëdhënësit e punëmarrësit;
  - Njohuri mbi Ligjin Nr. Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar;
  - Njohuri mbi VKM-në nr. 708 datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.
4. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:  
-50 pikë për jetëshkrimin/eksperiencën/pastërtinë e figurës  
-50 pikë për intervistën me gojë.
5. Shpallja e fituesve bëhet në faqen zyrtare brenda 3 ditëve pune nga përfundimi i intervistës.
6. Çdo kandidat ka të drejtën për ankim jo më vonë se 24 orë nga shpallja e listës së fituesve.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**EDMOND RRUSHI**

